

DATE 30/01/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje materiale për Ujësjellësin (saracineska, tuba, rakorderi, fasheta, bashkues etj) dhe Blerje materiale për Kanalet e Ujërave të ndotura (tuba korrogato, puseta etj).- Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Tuba kullimi, tuba kanalizimesh

VLERA E FONDIT LIMIT: 1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 24,999,500 (Njëzet e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjet e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh

Shumatore e cmimeve për njësi: 4,887,836 (Katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujesjelles Kanalizime Kamez Sh.aka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së (Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40 %** e vlerës së kontratës/ vlera e pritshme të kontratës që prokurohet përkatësisht **9,999,800 (Nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) LEKË**. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Është kërkuar vlera maksimale prej 40% e fondit limit pasi është vlerë lehtësisht e përballueshme nga OE .

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 të konfirmuara nga Organet tatimore shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar (vetëm në rastin kur janë objekt i nenshkrimit të auditimit), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht,

Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. “

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Janë kërkuar vetëm bilancet e dy viteve financiare për ti mundësuar AK vlerësimin nëse OE ka një aktivitet pozitiv dhe garanton kështu realizimin me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së fondit të limit përkatësisht **9,999,800 (Nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) LEKË.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2 Kërkohet të paraqiten mostra për artikujt e mëposhtem:

- | | |
|--|-------|
| a) Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=110mm, Pn 16 | cm 50 |
| b) Brryla PE Ø63 PN 16 | cop 1 |
| c) Fashete PP Ø63x1" , PN 16 | cop 1 |
| d) Manikota Xingato 1" | cop 1 |
| e) Kundravalvol me pallot bronzi 1" | cop 1 |
| f) Saracineska gize me flanaxha, Pn deri 16 bar, φ50 e kompletuar | cop 1 |
| g) Manikota PE Elektrofuzive Ø 50 PN 10 | cop 1 |
| h) Fasheta PE Elektrofuzive Ø63x25 PN 16 | cop 1 |
| i) Fasheta riparuese inoksi Ø110mm | cop 1 |
| j) Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm | cm 50 |
| k) Kapak gize grile C 250, 60x40 cm per Puset shiu | cop 1 |
| l) Tuba betoni Ø 200 mm | cop 1 |
| m) Pusete shkarkimi 60 x 60, h = 70 cm me kapak beton/arme 76x76x10cm. | cop 1 |

Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit pranë Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a ne adresen: Rruga "Paqesori", Frutikulture, Kamez

Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar,

Per piken 2.3.2. Njësia e Prokurimit gjykon se qëllimi i vendosur për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të

dorëzuar nga autoriteti kontraktor në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

Theksojmë se mostrat për produktet e kërkuara më lart nuk janë të ekzagjeruara në numër dhe dorëzimi i tyre është i rëndësishëm për autoritetin kontraktor në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së specifikimeve teknike me mostrat e dorëzuara me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi si dhe duke vlerësuar rendesine e objektit të prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalente— Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë . *Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga RSH.*

- Operatori ekonomik pjesëmarrës në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin për Tubat HDPE dhe Tubat e Betonit sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Për të përmbushur këto kriter operatorët ekonomikë duhet të paraqesin;

- **Prodhuesi duhet të paraqesë Certifikatën ISO 4427-1|:2019 ose ekuivalent. “Për sistemin e tubacioneve plastike për furnizimin me ujë, kullimet dhe kanalizimet nentokesore dhe mbitokesore nën presion”.**
- **Prodhuesi duhet të paraqesë Certifikatë EN 1916:2002/AC:2008 ose ekuivalent “Për prodhim betoni dhe i tubave dhe paisjeve të ndryshme të betonit, të pa forcuara dhe të forcuara me fibra çeliku”.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *Certifikat e sipërpermendura janë kërkuar nga ana e AK që operatorët ekonomik duhet të jenë të certifikuar për cilësinë e mallrave, që janë të lidhura ngushtë me objektin që prokurohet. Autoriteti kontraktor bazuar në zërat e materialeve të paraqitura në preventiv i lind e drejta të kërkojë certifikatë ISO me qëllim garantimin e cilësisë së materialeve që ka parashikuar për të blerë.*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin e Autoritetit Kontraktor sipas kërkesave të tij dhe ky furnizim të kryhet me shpenzimet e veta (shpenzimet e vetë operatorit ekonomik).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” .

2.3.5 Të ketë në pronësi ose me qera për transportin e mallrave me të cilat do të furnizoje Autoritetin Kontraktor automjete si më poshtë:

Nr	Mjetet	Sasia	Statusi pronesi / qira
1	Kamion mbi 8 ton	1	+
2	Kamion me vinc	2	+

Per automjetet ne perputhje me kodin rrugor te paraqiten certifikatat e pronesise, si dhe dokumentacioni perkates; siguracioni, leja e qarkullimit, aktin e kolaudimit te automjeteve ne dispozicion si dhe certifikate per transport mallrash.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. AK per tu siguruar qe OE ka kapacitetet per transportin e mallrave objekt prokurimi ka kerkuar qe OE te disponoj mjetet e mesiperme. Me qellim realizimin e procedures ne kohe korekte sipas kerkesave te AK

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar 1(nje) shofer kamioni dhe 1 (nje) manovrator.

-Per shoferin te paraqitet kontrata e punes dhe leja e drejtimit e vlefshme.

- *Per manovratorin duhet te paraqitet deshmia e aftesise profesionale per makinerite e renda sipas VKM Nr.706 date 01/07/2009 “Per paisjen e manovratoreve per pisjet e renda me deshmi profesionale” i ndryshuar, dhe rregullores Nr.2 Date.09/08/2013 “Per kushtet kriteret dhe programet per pregaditjen teorike praktike te kandidateve si dhe dhenien e deshmise se aftesise profesionale per perdoruesit e makinerive te renda per punime ndertimi dhe toke si dhe disiplinimi i perdorimit te tyre” dhe kontrata individuale e punës e vlefshme*
- *Punonjesit e sipercituar sipas profesioneve, duhet të jenë të pajisur gjithashtu edhe me kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga organe kompetente në bazë të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.*
- *Secili punonjes i sipercituar, duhet të figurojë në listëpagesen e shoqërisë për të pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave*
- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Plotesimi i pikes 2.3.5 dhe 2.3.6 ne fazen e ofertimit permbushet me paraqitjen e formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8. OE fitues perpara shpalljes se fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit do te paraqes prane OE dokumentat justifikues se bashku me dokumentat e tjera te ofertes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku të vërtetojë se mallrat e ofruara do të mbulohen me garanci përdorimi për 12 muaj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Sikcimet dhe parametrat teknike, si dhe grafiku levrimit te mallit gjenden bashkangjitur ne DST

Argumentimi:

Specifikimet Teknike të mallrave objekt prokurimi, janë përshkruar saktë dhe plotësisht, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve.

Në Specifikimet Teknike, nuk është përshkruar asnjë markë, specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara.

NJESIA E PROKURIMIT